

# Konceptet e Rexhep Ismajlit për gjuhën, karakterin identitar të saj dhe rishikimin e standardit

Haki Hysenaj

19 janar 2013

## Përmbledhje

Punimi ynë me titull: "*Konceptet e Rexhep Ismajli për gjuhën, karakterin identitar të saj dhe rishikimin e standardit*" nuk presupozon përshkrimin shterues të qëndrimeve të Ismajlit rreth këtyre tri çështjeve gjuhësore. Prandaj, në këtë punim, i cili nuk do mend se u nënshtrohet kritereve të botimit në një libër të posaçëm (Festschrift), në 65-vjetorin e lindjes së tij, vetëm do të vëmë në pah disa nga konceptet Ismajlit për çështjet e shtruara. Qëllimi konsiston në interpretimin e koncepteve që kanë të bëjnë me planifikimin, politikat gjuhësore, karakterin identitar të gjuhës, si dhe debatet që po bëhen sot rreth standardit të shqipes.

Preokupimi ynë nuk priret nga këmbëngulësia për të dhënë gjykime rreth çështjeve të përzgjedhura për interpretim, sa në këmbëngulësinë e përligjes së nevojës së shprehur gjithnjë e më shumë për rishikimin e standardit dhe pasurimin e tij edhe me forma të reja të idiomave të tjera të mbetura jashtë sistemit në kohën kur ishte kodifikuar shqipja, të iniciuara jo një herë edhe nga Ismajli.

## 1 Sfondi

Çështja e rishikimit të standardit, përmirësimi dhe pasurimit i tij edhe me forma e shprehje të mbetura jashtë sistemit sot ka lëkundur "respektin" për gjuhën. Krijimi i rrethanave të reja për shqipfolësit në Shqipëri e Kosovë, por edhe në Maqedoni, Mal të Zi, Preshevë dhe Bujanoc, kanë derivuar realitete krejtësisht të reja sociolinguistike për interpretime të kësaj natyre, njëjtë siç kanë krijuar realitete të reja edhe për përdorimin e gjuhës standarde shqipe. Prandaj, sot, si asnjëherë më parë, çështja e normimit të shqipes është duke u bërë çështje diskutimesh nivelesh të ndryshme.

Përderisa përvetësimi i standardit as sot e kësaj dite nuk ka mbërritur shkallë të kënaqshme në të gjitha viset ku flitet shqipja, debatet për këtë çështje tashmë njëjtësohen pikërisht me planifikimin dhe politikat gjuhësore me rastin e normimit të saj, shpesh duke i stigmatizuar ato si të imponuara, të njëanshme dhe si të karakterit ideologjik. Kjo ka bërë që çështja e planifikimit dhe politikat gjuhësore, të zbatuara me rastin e standardizimit në vitin 1972, këto vitet e fundit të mos jenë më tema tabu. Me këto çështje,

pos gjuhëtarëve, që përcjellin rrjedhat e gjuhës, shpeshherë merren, përtej kompetencës shkencore, edhe individë përgatitjesh të tjera, duke e shfrytëzuar kështu standardin e përfolur si "armë" edhe për qëllime jashtëgjuhësore. Por, ky nuk është argumenti kryesor në këtë realitet të ri, që kërkon këtë rishikim.

Diskutimet për dhe kundër gjuhës standarde shqipe, të cilat në shumë raste paraqesin ekstremim aktual në situatat krejtësisht të reja sociolinguistike të krijuara këtu dhe në Shqipëri, megjithatë duhen konsideruar si tregues se standardi i shqipes është duke kaluar nëpër një periudhë që shtron nevojën e rishikimit. E, në gjithë këtë vorbull diskutimesh, që s'ka dyshim se kanë lëkundur stabilitetin e standardit dhe respektin për të, interpretimet e bëra nga Rexhep Ismajli rreth këtyre çështjeve tash e gati tri decenie me radhë konsiderohen si interpretimet më të qëndrueshme dhe si të tilla duhen shfrytëzuar për çdo nismë të mirëfilltë të rishikimit të standardit.

## 2 Politika gjuhësore dhe planifikimi gjuhësor në rastin e shqipes

Sipas Ismajlit, konceptimi instrumentalist për gjuhën dhe planifikimin e saj ka qenë i njohur dhe ka vepruar në traditën e politikës gjuhësore shqiptare gjithashtu (Ismajli, 2003: 6). Duke konstatuar se gjuhët në gjendjen e tyre të natyrshme janë të pamjaftueshme dhe të papërsosura, Ismajli thekson se planifikimi gjuhësor synon përmirësimin drejt një ideali të karakterizuar nga hamendësimet e ngritura në rrafsh konceptesh me vlerë të pretenduar të përpiktë, si efikasiteti, njësia dhe bukuria, si shtyllat kryesore të shprehjes. Por, për këto koncepte shprehet se nuk kanë saktësi të vetvetishme, prandaj shton se ato mund të shërbejnë për mbulesa dhe mistifikime nga më të ndryshmet, duke u bërë madje edhe ideologema (Ismajli, 2003: 6). Për konceptet politikë gjuhësore dhe planifikim gjuhësor Ismajli thotë të jenë përdorur shpesh si sinonime edhe në studimet e gjuhëtarëve botërorë. Megjithatë, ai dallon nuanca kuptimore midis tyre. Në librin e tij "Në gjuhë" dhe "për gjuhë", duke cituar Cavlet-in, shtron tezën se "Politika gjuhësore është tërësia e zgjedhjeve në rrafshin e gjuhës dhe të jetës kombëtare, ndërsa planifikimi gjuhësor paraqet hulumtimin dhe zbatimin e mjeteve të domosdoshme për efektivitetin e një politike të caktuar gjuhësore (Ismajli, 1998:19). Sipas kësaj rezulton se politika gjuhësore del më heterogjene, e cila përfshin edhe specie të kulturës e të traditës së kombit, ndërsa planifikimi gjuhësor lidhet me normat në perspektivë për një gjuhë të përbashkët e të mjaftueshme për komunikim të një bashkësie të identifikuar si komb.

Debatet e sotme për standardin në fokus kanë pikërisht planifikimin gjuhësor, i cili kishte nisur qysh në kohën e Rilindjes Kombëtare, duke kaluar faza të ndryshme, për të kulmuar me standardizimin e shqipes në *Kongresin e Drejtshkrimit të vitit 1972*. Ky planifikim gjuhësor për gati një shekull ka pësuar në përzgjedhje dhe në formë, duke shfrytëzuar idioma të ndryshme si bazë standardi, përderisa pas Luftës II Botërore mernte pikënisje dialektin e toskërishtes, i cili në vitin 1972, i pasuruar edhe me disa trajta geqe, u ngrit në standard.

Rrethanat e ndryshme politiko-shoqërore, në të cilat bëhej zënia e standardit dhe përdorimi i tij në ligjërimet formale dhe joformale, ndryshonin nga Shqipëria në Kosovë.

Përderisa në Shqipëri standardi mbrohej edhe me ligj (nga viti 1974), në Kosovë situata rezultonte krejtësisht ndryshe. Ishte vetëm ndjenja kombëtare ajo që bënte "trysni" mbi shqipfolësit në Kosovë, por edhe në vise të tjera jashtë territorit administrativ të Shqipërisë, për zënien e tij, prandaj Ismajli këtë e shpjegon me karakterin identitar të gjuhës.

Sipas Ismajlit, planifikimi i statusit ishte avancuar në rrafshin e theksimit të njësisë kombëtare njësoj si në relacionin me gjuhët e tjera të ish-Jugosllavisë në rrafsh të standardizimit si etalon (**Ismajli, 2003: 28-29**). Ky është njëri ndër argumentet e shkoqitura shumë shkencërisht nga Ismajli, që arsyeton mënyrën e pranimit të standardit nga shqipfolësit kosovarë, por edhe shqipfolësit e trevave të tjera të ish-Jugosllavisë. Pranimi i standardit si vlerë gjithëkombëtare ishte bërë madje pa kontestuar as korpusin e tij, gjë që sot, në rrethanat e reja, edhe vetë autori insiston se ka hapësira për plotësimin e tij edhe me elemente të reja funksionale të idiomave të tjera dialektore, por gjithnjë duke ruajtur standardin si një të arritur kombëtare. Duke folur për periudhat nëpër të cilat ka kaluar standardizimi i shqipes, Ismajli përshkruan fazat e përhapjes së tij dhe të vetëdijes për të, të kultivimit dhe mbajtjes në jetë të normës eksplicite, të evaluimit të efikasitetit dhe të funksionalitetit të standardit të përzgjedhur në raport me hapësirat dhe nevojat e komunikimit publik, e të cilat konstaton se kanë ardhur duke u ndryshuar rrënjësisht në fillim të viteve '90. "*Në këtë proces hyn edhe rikonsiderimi apo ripërshtatja e standardit në pajtim me nevojat e reja të krijuara në shoqëri*" (**Ismajli, 2011: 42**).

Koncepti i Ismajlit për rikonsiderimin apo përshtatjen e standardit ndërthen më vete stabilitetin elastik, autonominë dhe polifunksionalitetin e tij. Këto tri tipare, po sipas tij, gjuhës standard në sytë e folësve i japin peshë shumë më të madhe dhe e bëjnë të ndikojë në format jostandarde dhe substandarde të gjuhës (Shih 2011:42-43).

### 3 Karakteri identitar i gjuhës

Planifikimi gjuhësor dhe ndoshta edhe karakteri identitar i gjuhës tashmë janë dy nga çështjet, të cilat, së paku këtu në Kosovë, prodhojnë debatet e përmendura. Duke mos i refuzuar ato, Rexhep Ismajli megjithatë përkujton "*periudhën e shtypjes së egër dhe të kërcënimit të identitetit*", si arsye për një afrim gjuhësor midis shqiptarëve në kohën para standardizimit të gjuhës shqipe. Në librin "Standarde dhe identitete" konstaton se në ish-Jugosllavi, pjesë e së cilës ishte Kosova, "*sikur po nxirrte krye ajo që quaj "sindrom maqedonas"*, tendencat e qarqeve serbe që synonin diferencimin e gjuhës sh(q)ipe (iptarski) për kosovarët dhe shqiptarët e ish-Jugosllavisë nga gjuha shqipe (Albanski) për shqiptarët e Shqipërisë" (**Ismajli, 2003: 26**). Prandaj, konstaton se "*Këtu bëhej "luftë për gjuhën"*, ndërsa në Shqipëri planifikimet bëheshin në suaza të shtetit, pa ngarkesat e këtilla, më parë bëhej "*një luftë në gjuhë, brenda gjuhës*", gjë që do të thotë se karakteri "*identitar*" i gjuhës në Shqipëri nuk paraqiste ndonjë problem. Gjithnjë në këtë prizëm, duke pasur parasysh situatat socio-politike në të cilat gjendeshin shqiptarët jashtë kufijve të Shqipërisë, Ismajli pohon se "*Aspektet e luftës për vlerat simbolike, për identitetin e kërcënuar kombëtar, peshonin më shumë*" (**Ismajli, 2003:28-29**).

Pas hulumtimit të shumë dokumenteve zyrtare dhe shkrimeve në gazetën e vetme

shqipe në Kosovë, "**Rilindja**", për rrjedhat planifikuese të gjuhës, Ismajli konkludon se në këtë luftë për statusin e gjuhës në raport me identitetin kombëtar, për një moment bëri që të neglizhohej çështja e korpusit- mjaft që ishte shqip, ose të lihej si e dorës së dytë, si gjuhë e vetme letrare u pranua ajo që ishte paraqitur si **Projekt i rregullave të drejtshkrimit më 1967 në Tiranë**, pavarësisht nga fakti se bazohej në toskërishten letrare (Shih 2003: 28).

Duke u nisur nga rrethanat e reja të krijuara pas shkëputjeve të komunikimeve me Serbinë, autori tashmë pohon se disa nga mitet e mëparshme si "*karakteri popullor i gjuhës letrare*" nuk mund të funksiononin më (Ismajli, 2003: 32). Me këtë konstatim sikur autori lë të hapur mundësinë për rishikimin e standardit të vitit 1972. Madje, duke parë lëvizjet në përdorimin e tij pas rënies së socializmit në Shqipëri, Ismajli shton se sikur nisi të bëhej e zakonshme në mediumet e Tiranës rikthimi te toskërishtja në realizimin e standardit, pra sikur nisi të bëhej i zakonshëm identifikimi i toskërishtes me standardin. "*Dhe kjo krijonte efekte që kanë peshë psikologjike për motivimin e refuzimeve të ndryshme, që lindën në ndërkohë*" (Ismajli, 2003: 32). Këto kontestime të standardit Ismajli i sheh edhe në mungesën e tolerancës gjuhësore dhe në identifikimin e toskërishtes si gjuhë standarde. "*...sipas këtyre reagimeve, folësit e një areali gjeografik i vë në pozitë të privilegjuar* (është fjala për standardin, v. j.), *ndërsa të tjerët në pozitë të nënshtruar*", shprehet Ismajli. Me gjithë këto konstatime, Ismajli shton se *krahas reagimit kundër segregacionit të folësve, mund të ketë edhe çështje të tjera që duhen shikuar*.

Rexhep Ismajli, në studimet e tija, analizon edhe fillimin e të gjitha kontestimeve të standardit të gjuhës shqipe. Thekson se ato së pari filluan të vinin nga intelektualë të persekutuar, që jetonin në diasporën shqiptare, e të cilët në krijimet e tyre vazhdonin të përdornin varietetin e gegërishtes letrare. Prirje të njëjta u shfaqën edhe në Kosovë, por edhe në Shqipërinë e veriut, sidomos pas ndërrimeve të sistemeve dhe regjimeve totalitare që kishin dirigjuar në mënyra të ndryshme edhe me gjuhën si mjet komunikimi.

Për këto çështje Ismajli ka shkruar artikuj dhe studime të ndryshme. Ndër to duhen veçuar: "**Gjuhë dhe etni**" (1991), "**Në gjuhë**" dhe për "**gjuhë**" (1998), "**Standarde dhe identitete**" (2003). Me këto studime nuk ka dyshim se autori përlligj nevojën që standardi i shqipes "*së kontestuar*" të rivlerësohet, në mënyrë që të gjithë përdoruesit e saj ta ndiejnë veten komod në të gjitha domenet e komunikimit.

## 4 Standardi i shqipes në rrethanat e reja sociolinguistike

Siç u tha edhe më lart, vetë Ismajli ka shtruar publikisht nevojën e rishikimit të standardit, duke shpërfaqur edhe shembuj përvojash të shteteve me gjuhë shumë më herët të standardizuara dhe me numër shumë më të madh folësish (shih 2011: 50). Në librin "**Standarde dhe identitete**" thekson se "procese rivështrimi dhe rirregullimi, si këta që kërkohen në Kosovë dhe gjetiu, si në pikën a., ndodhin në të gjitha hapësirat ku ka gjuhë standarde dhe duan parë si gjë krejt e zakonshme dhe e dobishme për vetë standardin (Ismajli, 2003: 49). Mirëpo, duke kundërshtuar mohimin e standardit të ngritur në vitin 1972, shton se mundësia e rikthimit të dy varianteve letrare me status relativisht të përkufizuar, ndërkaq, do të hapte rrugë për eventualitetin e krijimit të dy gjuhëve

letrare dhe për gjithfarë zhvillimesh në varësi nga lëvizjet e tjera politike brenda kombit me më shumë qendra të vendosjes politike në rajon (**Ismajli,2003: 49**).

Ndërsa në kumtesën "**Politika (e munguar) e gjuhës**" Rexhep Ismajli potencon se një politikë e integruar e gjuhës shqipe duhet të ngërthejë në vete patjetër elemente që varen nga këto realitete dhe të ketë shkallëshkallshmërinë që presupozon ky realitet kompleks (**Ismajli, 2011: 38**). Këtu është fjala për hapësirë komunikimi me dimensione dhe mundësi shumë të ndryshme përdorimi të shqipes dhe me realitete po ashtu dispartate politike, kombëtare, shoqërore e vlerore, prandaj zbërthen konceptin se injorimi i këtyre realiteteve nga ndonjëra prej hapësirave mund të krijojë pasoja për tërësinë (**Ismajli,2011: 40**). Duke arsyetuar qëndrimin e tij për zhvillimin natyror të gjuhës, pavarësisht të përcaktimit të një standardi në një kohë të caktuar, Ismajli megjithatë thekson se "*Normimi ideal nuk mund të arrihet as për një moment të caktuar, e lëre më për kohë më të gjata*" (**Ismajli,1991: 314**).

#### REFERENCAT:

- 1.**Ismajli, R.**, "*Rreth shqipes standarde, kodeve të tjera dhe kontestimeve*", Studime Filologjike, 1-2, Tiranë.
- 2.**Ismajli, R.**, "*Në gjuhë " dhe "për gjuhë"*, Dukagjini, Pejë.
- 3.**Ismajli, R.**, "*Standarde dhe identitete*", Dukagjini, Pejë.
- 4.**Ismajli, R.**, "*Politika (e munguar) e gjuhës*", në *Shqipja në etapën e sotme:politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit*, QSA, Tiranë.
- 5.**Ismajli, R.**, "*Gjuhë dhe etni*", Rilindja, Prishtinë.